

NOTË INFORMUESE

Tiranë, më 10. 9. 2025

Mbi kërkesën për procedim disiplinor me masën “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40%, deri në një vit”, për magjistratin Sh.L.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj magjistratit Sh.L., gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Sarandë, bazuar në 13 ankesa për vonesa në zbardhjen e vendimeve të arsyetuara nga gjyqtari, shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “d” i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti voluminoz i hetimit të inspektorëve të ILD-së, që ka bashkuar dy procedime dhe gjatë procesit ka ndryshuar e shtuar objekt hetimi për këtë gjyqtar, ka evidentuar vonesa të përsëritura të zbardhjes së vendimeve në tejkalim të afatit ligjor deri në 4 vite, vendime që i përkasin periudhës së viteve 2021, 2022, 2023. Raporti i inspektorëve të ILD konkludon se:

- Nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime/mosveprime në shkelje të afateve procedurale civile dhe penale të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke tejkaluar afatet tej çdo logjike, ku mosrespektimi i afateve ligjore nuk paraqitet si episod i izoluar, por si model i përsëritur në tri vite radhazi dhe në përmasa jashtë çdo standardi ligjor dhe profesional të afateve të vonesës. Zvarritja sistematike dhe e përsëritur përtej këtyre afateve, përbën tregues të qartë të mosrespektimit të përgjegjësiwe funksionale.
- Pavarësisht për sa ka parashtruar magjistrati lidhur me ngarkesën në punë dhe për gjendjen e sistemit gjyqësor, nga analiza e situatës rezulton se ai nuk ka përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme detyrimet ligjore dhe funksionale që i ngarkohen për arsyetimin dhe dorëzimin në kohë të vendimeve gjyqësore.
- Magjistrati ka një vjetërsi në detyrë prej 5 vitesh si gjyqtar, ndërsa shkeljet disiplinore janë evidentuar në vitin e dytë të tretë dhe të katërt të detyrës, tregues ky i eksperiencës së pakët në profesion. Por pavarësisht eksperiencës në detyrë, gjyqtari ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të.
- Shkelja disiplinore ka sjellë mos marrje në kohë të produktit të pritshëm nga gjykimi i një çështjeje të caktuar, vonesa në ushtrimin e të drejtës së ankimit apo edhe vonesa të theksuara në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si pasojë e mos arsyetimit në kohë të vendimeve, pra një drejtësi e mohuar.
- Sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes, pas fillimit të hetimit dhe gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor ka qenë bashkëpunuese.

ILD konkludon se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Sh.L., përbëjnë “Shkelje të rëndë disiplinore” dhe i propozojnë Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.